



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1168/2 prot.,

Datë 14.05.2024

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “BNT Electronics” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF- 00117-04-04-2024, me objekt: “Blerje pajisje printimi për KESH Qendër dhe Njësitë e Prodhimit ” me fond limit 15,000,000 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 22.04.2024 nga autoriteti kontraktor, KESH sh.a (Korporata Elektroenergjitiko Shqiptare).
- Ankimues:** Operatori ekonomik “BNT Electronics” SHPK, me NUIS J61817047D, me adresë: Bulevardi Zhan D'ark, Nd.32, Hyrja 16, Kati 2, Ap.1, Tiranë
- Autoriteti Kontraktor:** KESH sh.a (Korporata Elektroenergjitiko Shqiptare)
Rruga “Viktor Eftimiu”, Blloku “Vasil Shanto”, Tiranë

Në datën 13.05.2024, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2024/4078 protokolluar me nr. 1168/2024 protokolli, datë 13.05.2024 e operatorit ekonomik “BNT Electronics” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF- 00117-04-04-2024, me objekt: “Blerje pajisje printimi për KESH Qendër dhe Njësitë e Prodhimit ” me fond limit 15,000,000 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 22.04.2024 nga autoriteti kontraktor, KESH sh.a (Korporata Elektroenergjitiko Shqiptare).

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “BNT Electronics” SHPK.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:

b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”, Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik “BNT Electronics” SHPK, kundërshton me anë të ankesës me nr. 1168 prot.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyet e skualifikimit si më poshtë vijon:

Arsyet e skualifikimit:

“OE BNT Electronics ka paraqitur ofertë ekonomike anomalisht të ulët. OE skualifikohet në zbatim të nenit 93 pika 5 të ligjit 162/2020, i ndryshuar, e cila citohet se: 5. Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, autoritetet ose entet kontraktore refuzojnë pa kërkuar shpjegime një ofertë, e cila është konstatuar anomalisht e ulët.”..”

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 14.05.2024.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Kryetar

Jonaid Myzyri